



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi, Nr.8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

E Enjte, 11 Nëntor 2010

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Njësia nr. 8: Toka dhe ndërtesë e dëmtuar “ENG Beton” Kamenicë tërhiqet nga likuidimi me shitje të aseteve nr. 5

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se ka tërhequr nga likuidimi me shitje të aseteve nr. 5. Njësine nr. 8: Toka dhe ndërtesë e dëmtuar “ENG Beton” Kamenicë.

Kjo njësi, që përfshin një parcelë toke dhe një ndërtesë të dëmtuar, pronë e NSh ENG Beton me një sipërfaqe të përafërt prej 294 m² që ndodhet në rrugën kryesore të qytetit të Kamenicës, ishte paraparë të privatizohen përmes procesit të likuidimit me shitje të aseteve numër 5 me datën 1 Dhjetor 2010.

Lista e tenderëve për privatizim për shitjen e aseteve numër 5, përmban 28 Njësi/Asete.

Më poshtë mund të gjeni listën e plotë të Njësive/Aseteve që do të privatizohen përmes likuidimit 5:

Njësia 1: Bujqësia, Fushë Kosovë – Toka Bujqësore Markoc - Toka gjendet në Komunën e Obiliqit. Toka përfshinë ngastrat kadastrale nr. 5, 6/2, 7/1, 7/2, 13, 14, 28/1, 29/1, 42/1, 288 dhe 292 në zonën kadastrale Obiliq, me një sipërfaqe të përafërt prej 233463 m² (23 ha 34 ari dhe 63m²).

Njësia 2: Bujqësia, Fushë Kosovë – Toka Bujqësore Plemetin - Toka gjendet në Komunën e Obiliqit. Toka përfshinë ngastrat kadastrale nr. 352, 781, 804 dhe 814 në zonën kadastrale Plemetin, me një sipërfaqe të përafërt prej 196460 m² (19 ha 64 ari dhe 60m²).

Njësia 3: Bujqësia, Fushë Kosovë – Toka Bujqësore Sllatinë e Madhe - Toka gjendet në Komunën e Fushë Kosovës. Toka përfshinë ngastrat kadastrale nr. 14/1, 14/2, 14/3, 14/4, 18, 28/1, 28/2, 94, 248, 249, 252/1, 252/2, 257, 258, 259,

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Zt.Ylli Kaloshi në ylli.kaloshi@pak-ks.org
apo në 038 500 400 lokali 2006

263/2, 657, 658/1, 658/2, 658/3 dhe 658/4 në zonën kadastrale Sllatinë e Madhe, me një sipërfaqe të përafërt prej 460755 m² (46 ha 07 ari dhe 55m²).

Njësia 4: Bujqësia, Lipjan – Toka Bujqësore në Babush – Toka gjendet në komunën e Ferizajt. Toka përfshinë ngastrat kadastrale nr. 131/1 dhe 131/2 në zonën kadastrale Babush i Serbëve, me një sipërfaqe të përafërt prej 30875m² (3 ha 08 ari dhe 75m²).

Njësia 5: Bujqësia, Lipjan – Toka Bujqësore Livagje A – Toka gjendet në Komunën e Graçanicës. Toka përfshinë ngastrat kadastrale nr. 47/1 dhe 48 në zonën kadastrale Livagjë, me një sipërfaqe të përafërt prej 194275m² (19 ha 42 ari dhe 75m²).

Njësia 6: Bujqësia, Lipjan – Toka Bujqësore Livagje B - Toka gjendet në Komunën e Graçanicës. Toka përfshinë ngastrat kadastrale nr. 1444/1, 1444/2, 1445/1, 1450, 1451, 1452, 1453, 1456, 1912/2, 1912/3, 1918 dhe 1921 në zonën kadastrale Livagjë, me një sipërfaqe të përafërt prej 58701m² (5 ha 87 ari dhe 01m²).

Njësia 7: Bujqësia, Lipjan, Toka Bujqësore në Grackë e Vjetër – Toka gjendet në Komunën e Lipjanit. Toka përfshinë ngastrat kadastrale nr. 1, 2/3, 2/4, 4,5 dhe 6 zona kadastrale Grackë e Vjetër, me një sipërfaqe të përafërt prej 106252m² (10 ha 62 ari dhe 52m²).

Njësia 9: “17 Nëntori” Depoja- ndodhet në qendër të qytetit të Pejës në rrugën Xhemajl Shkololli, afër Çarshi Xhamisë. Në të kaluarën, ky aset është shfrytëzuar si depo e artikujve të ndryshëm. Depoja, është ndërtesë njëkatëshe nga betoni dhe tullat dhe ndodhet në ngastrën 665/2, me sipërfaqe totale prej rreth 120m². Pas konfliktit të vitit 1999, Depoja nuk është shfrytëzuar nga NSH-ja.

Njësia 10: “17 Nëntori” Ekonomati (ngastra) - ndodhet në qendër të qytetit të Pejës, në një rrugë të frekuentuar afër Çarshisë së Gjatë. Në të kaluarën ka shërbyer si dyqan me pakicë. Dyqani, ishte ndërtesë njëkatëshe nga betoni dhe tullat dhe kishte sipërfaqe totale prej rreth 120 m². Dyqani, është shkatërruar plotësisht gjatë luftës së vitit 1999.

Njësia 11: Trasing Pajisje të Lëvizshme -Aseti, pjesë e kësaj shitjeje i ofron mundësinë investitorit të mundshëm që të ketë në posedim paisje të përdorura dhe mbeturina të metalit të cilat gjenden në Zonën Industriale, Prishtinë.

Njësia 12: Gërmia Dyqani Nr. 6 Qafa, - Aseti, pjesë e kësaj shitjeje përfshinë sipërfaqen e lokalit afarist me sipërfaqe prej përafërsisht 128.84 m² i cili gjendet në katin e parë në objektin shumëkatësh e njohur si “Kompleksi Qafa” në qendër të Prishtinës.

Njësia 13: Gërmia Shitorja Nr. 1 Lakrishte - Aseti, pjesë e kësaj shitjeje përfshinë sipërfaqen e lokalit afarist me sipërfaqe prej përafërsisht 64.04 m² i cili gjendet në katin përdhësë në soliterin nr. 1 në lagjen "Lakrishte" në Prishtinë.

Njësia 14: "19 Qershori" Toka në Podujevë -Aseti, pjesë e kësaj shitjeje përfshinë vetëm sipërfaqen e tokës prej përafërsisht 10 ha 04 ari 99 m² (100,499 m²) në Zonat Kadastrale Llapashticë e Epërme dhe Llapashticë e Poshtme në Podujevë. Pjesë e kësaj shitje është vetëm toka e cila, në të kaluarën, është përdorur nga NSH-ja për nxjerrjen e lëndës së parë për prodhimin e tullave.

Njësia 15: "Banesa", Dy shitore në Ortakoll IV, L/2D, Prizren – përfshinë dy (2) shitore me sipërfaqe të përgjithshme të shitoreve prej 74.88 m² dhe bodrume me sipërfaqe të përgjithshme prej 68.31 m², që gjinden në ndërtesën afarist/banesor, Rr. "11 Marsi" / Ortakoll IV, Lam 2D, Prizren.

Njësia 16: "Komuna" – Shitorja nr.5 në Mitrovicë - ofron për shitje një shitore me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 44 m², e cila gjendet në adresë: rr. "Adem Jashari" nr.56, Mitrovicë.

Njësia 17: KB Vushtrria Tokë dhe Ndërtesa – Prona gjendet ne qytetin e Vushtrrisë në rrugën kryesore. Toka me përafërsisht 4020 m² (parcela numër 2233), me dy ndërtesa – një ndërtesë administrative me përafërsisht 232 m² që përmban dy zyra, djathore dhe një dyqan, një aneks objekt/depo me sipërfaqe 180 m² dhe Pompën e Derivateve.

Njësia 18: Fabrika e Plastikës Skenderaj Tokë A - Përafërsisht 8,993m² (89ari, 93m²) tokë bujqësore në Zonën Kadastrale të Skenderajt, Certifikata Nr. UL-72015063-00334, parcelat nr. 191,201,202.

Njësia 19: Fabrika e Plastikës Skenderaj Tokë B - Tokë me përafërsisht 4,311m² (43 ari, 11m²) tokë bujqësore në Zonën Kadastrale Klinë e Poshtme / Donja Klina, komuna Skenderaj, Certifikata Nr. UL-72015063-00166, parcelat nr. 692,693.

Njësia 20: Fabrika e Plastikës Skenderaj Tokë C - Përafërsisht 2,560m² (25 ari, 60m²) tokë bujqësore në Zonën Kadastrale Klinë e Poshtme / Donja Klina, komuna Skenderaj, Certifikata Nr. UL-72015063-00166, parcelat nr. 690,691.

Njësia 21: Runiku Tokë A - Tokë me sipërfaqe prej 3,595m² (35ari 95m²) në Zonën Kadastrale Runik, të komunës së Skenderajt, Certifikata Nr. UL-72015062-00131, parcela 668-0.

Njësia 22: Runiku Tokë B- Tokë me sipërfaqe prej 5,571m² (55 ari 71m²) në Zonën Kadastrale Runik, të komunës së Skenderajt, Certifikata Nr. UL-72015062-00131, parcela1840-0.

Njësia 23: Runiku Tokë C - Tokë me sipërfaqe prej 22,152m² (2ha 21ari 52m²) në Zonën Kadastrale Runik, të komunës së Skenderajt, Certifikata Nr. UL-72015062-00131, parcelat 1868-0 dhe 1869-0.

Njësia 24: Teuta Bare Dyqan - Dyqan prej 92.69 m² (kontrata e blerjes nr 1190/85) gjendet në pjesën veriore të Mitrovicës. Dyqani është i përshtatshëm në mënyrë ideale për aktivitete të ndryshme komerciale. NSH Teuta - Bare u bë pronar i dyqanit në bazë të kontratës se Blerjes që është nënshkruar më 13 qershor 1985 ndërmjet SIZ dhe Partizanka nga Titova Uzhica (te njohur si NSH Teuta Bare).

Njësia 25: Derma Commerce - Shitore me ndërtim të përkohshëm -Kjo shitje u ofron mundësi investitorëve potencial që të blejnë shitore me ndërtim të përkohshëm, me sipërfaqe rreth 25 m², me lokacion në zone tregtare në qytetin e Therandës, Komuna e Therandës, ne afërsi të rrugës kryesore Therandë - Prizren.

Njësia 26: Turiqevci Toka A - tokë prej 1,045 m² (Certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL nr. 72015072-00174, parcela nr. 308/2) e cila gjendet në Fshatin Turiqevc, Komuna e Skenderajt. Toka është e përshtatshme për qëllime bujqësore dhe/ose banuese.

Njësia 27: Turiqevci Toka B – tokë prej 507 m² (Certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL nr. 72015072-00174, parcela nr. 308/3) e cila gjendet në Fshatin Turiqevc, Komuna e Skenderajt. Toka është e përshtatshme për qëllime bujqësore dhe/ose banuese.

Njësia 28: Turiqevci Toka C – tokë prej 61 m² (Certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL nr. 72015072-00174, parcela nr. 308/4) e cila gjendet në Fshatin Turiqevc, Komuna e Skenderajt. Toka është e përshtatshme për qëllime bujqësore dhe/ose ndërtimore.

Njësia 29: Turiqevci Toka D - tokë prej 78 m² (Certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL nr. 72015072-00174, parcela nr. 308/5) e cila gjendet në Fshatin Turiqevc, Komuna e Skenderajt. Toka është e përshtatshme për qëllime bujqësore dhe/ose ndërtimore.